



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

Kodi: 038

KEC

MENAXHIMI CIKLIK I PROJEKTIT

Qëllimet e modulit
Module Aim

Pajisja e vijuesve me shkathtësi për menaxhimin ciklik të projekteve

Rezultatet e të nxënit
Learning Outcomes

Me përfundimin e këtij moduli vijuesit do të jenë në gjendje:

- Të vlerësojnë përdorimin e planifikimit strategjik në punën e tyre,*
- Të shkruajnë projekt-propozime dhe dokumente strategjike duke u bazuar në procese të planifikimit me pjesëmarrje dhe në qasjen e kornizës logjike,*
- Të zhvillojnë strukturën për zbërthimin e detyrave (WBS),*
- Të zhvillojnë, monitorojnë dhe kontrollojnë oraret e implementimit,*
- Të zhvillojnë plane monitorimi dhe ta bëjnë procesin e monitorimit,*

Përmbajtja e modulit
Module Content

Hyrje në planifikimin strategjik. Planifikimi i strategjive, programeve dhe projekteve. Analiza e palëve me interes. Si të organizohet një punëtori planifikimi me pjesëmarrje? Definimi i problemeve. Raporti “shkak-pasojë”. Matrica e kornizës logjike. Analiza e rrezikut.

Objektivat dhe terminologjia e WBS. Zbërthimi i sistemit në pako të menaxhueshme. Përfshirja e ekipit në proces. Dobia e WBS.

Të kuptuarit e orareve të implementimit dhe terminologjisë. Tipet e orareve. Diagrami i Ghantit. Rruga kritike. Softueri i specializuar për orare.

Buxheti i Projektit. Termat e referencës. Udhëzimet për aplikantë

Koncepti i monitorimit. Hapat e monitorimit. Tipet e monitorimit. Zhvillimi i veglave të monitorimit.

Shembuj të ndryshëm planifikimi dhe prezantimi të projekteve/dokumente strategjike – përvojat e mira.

Shkruarja e projekt-propozimeve efektive.

Parakushtet
Pre-Requisite(s)

Nuk ka

Kërkesat paralele
Co-Requisite(s)

Nuk ka

**Strategjitë e mësimdhënies & nxënies
Teaching & Learning Strategies**

*Mësimi problemor
Prezantimet dhe diskutimet javore
Leximi i materialeve*

Pjesa e mësimdhënies do të realizohet përmes një projekti simulues të përbashkët. Varësisht nga struktura e vijuesve ky mund të jetë një projekt real për të cilin vijuesit kanë interes të përbashkët.

Vijuesit ndahen në grupe nga 4-5 persona, në varësi nga interesimi i tyre për të punuar në një fushë. Secili grup zgjedhë një projekt nga fushëveprimi i vet, të cilin do ta zhvillojë deri në përfundim të kursit, duke i ndjekur të gjitha procedurat e planifikimit dhe të monitorimit. Produkti përfundimtar do të jetë projekt-propozimi i kompletuar me të gjitha elementet e nevojshme.

Ofertuesi i trajnimit merr mbi vete barrën për përgatitjen dhe mirëmbajtjen e një ueb faqeje që do të shërbejë si pikë referimi për pjesëmarrësit e trajnimit.

**Protokolet e vlerësimit
Assessment Protocols**

Vlerësimi do të bëhet në bazë të grupit dhe të detyrave që i kryen grupi, në mënyrë të vazhdueshme. Fazat kryesore të vlerësimit janë:

- 1. Prezantimi i idesë së projektit – 0 pikë(kusht i domosdoshëm)*
- 2. Trngjet e problemeve dhe të objektivave – 20 pikë*
- 3. Arsyetimi i projektit – 10 pikë*
- 4. Matrica e kornizës logjike të projektit – 20 pikë*
- 5. Përshkrimi i aktiviteteve dhe plani i zbatimit – 15 pikë*
- 6. Buxheti/Plani i monitorimit të projektit – 15 pikë*
- 7. Finalizimi dhe prezantimi i projektit – 20 pikë*

Maksimumi i pikëve: 100

**Organizimi i mësimit
Delivery Schedule**

10 Ligjërata-Lecture
38 Ushtrime Tutorial

**Kohëzgjatja- Duration (h)
Ngarkesa e përgjithsh. (h)
Learner workload (hrs)**

Orë mësimi 48
Punë e pav. 56
104

Kushtet e certifikimit

Certification requirements

Kusht për certifikim është pjesëmarrja në të paktën 50% të orëve të mësimit, aktiviteti i dëshmuar brenda grupit të punës dhe minimumi prej 60 pikëve të fituara në procesin e vlerësimit.

Bibliografia

Bibliography

*Dukagjin Pupovci: Planifikimi i projekteve me pjesëmarrje – manual trajnimi, nëntor 2004.
Është në dispozicion edhe në gjuhën angleze, serbe, bullgare dhe rumune.*